

KËRKESË
Nr. 2006, datë 23.8.2021

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“BLOJA”

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar, është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar: largim i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, institucioni ynë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. “Bloja” (NIPT: J61817056C)

DREJTOR
Oltian Gjyzeli

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. AKM-TR-2021-000006—5

Datë 21.6.2021

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. AKM-TR-2021-000006-2, datë 25.5.2021, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “BLOJA”, me NIPT: J61817056C, përfaqësues i autorizuar i subjektit Murat Klobocishta, prej datës 25.5.2021, ora 08:30 deri më datë 25.5.2021, ora 16:30.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datë 25.5.2021 dhe e njoftoi më datë 25.5.2021.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

-Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, neni 62, pika 6.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit:

-Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, neni 62, pika 6, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 1 000 000 lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

-

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Jetnor Zhelegu ID:

Andi Kuci ID:

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “BLOJA” ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror” të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.